

VENDIM
Nr. 587, datë 25.9.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT (ASISTENCA TEKNIKE)
SHQIPËRIA: REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE VORË–HANI I
HOTIT/ZBATIMI I PROJEKTIT DHE MBIKËQYRJA E PUNIMEVE, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE HEKURUDHËS SHQIPTARE SHA, DHE
BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, MBËSHTETUR NGA
FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, (asistenca teknike) Shqipëria: Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë–Hani i Hotit/zbatimi i projektit dhe mbikëqyrja e punimeve, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hekurudhës Shqiptare sh.a., dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, mbështetur nga Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VERSION EKZEKUTIMI
Marrëveshje Granti nr. 17610-132312-132313-53468
Projekti TCRS nr. 17610
Detyra TCRS nr. 132312; 132313
DTM nr. 53468

MARRËVESHJE GRANTI (ASISTENCË TEKNIKE)
SHQIPËRIA: REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE VORË–HANI I HOTIT
PROJEKTI PËR ZBATIMIN DHE MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE HEKURUDHËS SHQIPTARE SHA
DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM,
MBËSHTETUR NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN PËR BALLKANIN
PERËNDIMOR
Datë 26 korrik 2024

TABELA E PËRMBAJTJES
NENI I – PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
Seksioni 1.01. Përkufizimet
Seksioni 1.02. Interpretimi
NENI II – FINANCIMI I GRANTIT
Seksioni 2.01. Shuma dhe qëllimi
Seksioni 2.02. Pagesa e Grantit

Seksioni 2.03. Pagesat
 Seksioni 2.04. Taksat dhe detyrimet
 Seksioni 2.05. Ndarja e kostove
 NENI III – KUSHTET PARAPRAKE
 Seksioni 3.01. Pagesa e parë e Grantit
 Seksioni 3.02. Të gjitha pagesat e Grantit
 NENI IV – DETYRIMET E MARRËSIT DHE TË SUBJEKTTIT TË PROJEKTTIT
 Seksioni 4.01. Zhvillimi i operacioneve
 Seksioni 4.02. Përdorimi i Grantit
 Seksioni 4.03. Njësia e Zbatimit të Projektit
 Seksioni 4.04. Prokurimi
 Seksioni 4.05. Kontratat e Konsulencës
 Seksioni 4.06. Dokumentacioni financiar dhe raportet financiare
 Seksioni 4.07. Furnizimi me informacione
 Seksioni 4.08. Mashtrimi dhe Korrupsioni
 Seksioni 4.09. Puna e fëmijëve
 Seksioni 4.10. Vizibiliteti
 Seksioni 4.11. Inspektimi dhe auditimi
 NENI V – Dokumentet dhe garancitë
 Seksioni 5.01. Dokumentet
 Seksioni 5.02. Pranimi dhe përsëritja
 NENI VI – PEZULLIMI DHE ANULIMI
 Seksioni 6.01. Anulimi nga marrësi
 Seksioni 6.02. Pezullimi ose anulimi nga BERZH-i
 Seksioni 6.03. Rastet e rimbursimit
 NENI VII – TË NDRYSHME
 Seksioni 7.01. Kohëzgjatja dhe përfundimi
 Seksioni 7.02. Vlefshmëria e disa dispozitave
 Seksioni 7.03. Marrëveshja si një e tërë; amendimet dhe heqja dorë
 Seksioni 7.04. Njoftimet
 Seksioni 7.06. Të drejtat, mjetet ligjore dhe heqjet dorë
 Seksioni 7.07. Përgjegjësia dhe zhdëmtimi
 Seksioni 7.08. Konflikti i interesit
 Seksioni 7.09. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
 Seksioni 7.10. Pasuesit dhe drejtëmarrësit; të drejtat e palëve të treta
 Seksioni 7.11. Zbulimi
 Seksioni 7.12. Kopjet e Marrëveshjes
 SHTOJCA A: FORMA E KËRKESËS PËR PAGESË
 SHTOJCA B: FORMA E CERTIFIKATËS SË DETYRËS DHE AUTORITETIT
 SKEDULI 1: ZËRAT QË FINANCOHEN NGA GRANTI

MARRËVESHJE GRANTI (ASISTENCË TEKNIKE) nr. 17610-132312-132313-53468

Kjo Marrëveshje Granti (kjo “Marrëveshje”) e datës 26 korrik 2024 lidhet ndërmjet:

1. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH”), institucion financiar ndërkombëtar i themeluar sipas Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një traktat shumëpalësh i nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, me seli në 5 Bank Street, London E14 4BG, United Kingdom (“EBRD”);

2. Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, me adresë zyrtare në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë, Shqipëri (“Marrësi”); dhe

3. Hekurudhës Shqiptare sh.a., me adresë zyrtare në L.NR3, Rruga Egnatia, Durrës, Shqipëri (“Subjekti i Projektit”, dhe së bashku me BERZH-in dhe Marrësin, “Palët”).

Duke pasur parasysh se:

A. Më 26 shkurt 2024, BERZH-i (në cilësinë e Huadhënësit) ka lidhur një marrëveshje huaje (“Marrëveshja e Huas”) me Republikën e Shqipërisë (në cilësinë e Huamarrësit, “Huamarrësi”), sipas së cilës BERZH-i ra dakord të japë një hua deri në shumën prej 98,750,000 eurosh (“Huaja”) për të financuar rehabilitimin dhe elektrifikimin e rreth 120 km të linjës hekurudhore midis Vorës dhe Hanit të Hotit (“**Projekti**”).

B. BERZH-i ka lidhur: i. një marrëveshje projekti (“**Marrëveshja e Projektit**”) në datën 4 mars 2024 me subjektin e Projektit, sipas së cilës subjekti i Projektit bie dakord të zbatojë Projektin në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Projektit; dhe ii. një marrëveshje granti për investim (“**Marrëveshja e Grantit të Investimeve WBIF – Pjesa 1**”) e datës ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje me Marrësin dhe Subjektin e Projektit, sipas së cilës BERZH-i bie dakord të japë një grant investimi prej 125,813,039 eurosh nga burimet e Fondit (siç përcaktohet më poshtë), në varësi të plotësimit të kushteve të përcaktuara aty.

C. Sipas nenit 20 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës, Banka ka themeluar Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“**Fondi**”), të cilin BERZH-i e menaxhon dhe administron në përputhje me kushtet e përgjithshme të datës 7 nëntor 2006, të cilat mund të ndryshohen herë pas here (“**Kushtet e Përgjithshme të Fondit**”).

D. Më 1 prill 2022, Asambleja e Kontribuesve të Fondit ra dakord që në varësi të plotësimit të kushteve të parashikuara në Kushtet e Përgjithshme të Fondit, t’i japë Marrësit një grant deri në shumën prej 7,500,000 eurosh nga burimet e Fondit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje, për angazhimin e konsulentëve, duke lidhur kontrata konsulence me secilin konsulent në përputhje me Zërat e Financuar nga Granti (“**Kontrata e Konsulencës**”), sipas së cilës konsulentët do të ofrojnë asistencë teknike për Subjektin e Projektit, të përshkruar më tej në këtë Marrëveshje (“**Shërbimet e Konsulencës**”), të nevojshme për qëllimet e zbatimit të Projektit.

Palët Bien Dakord si më poshtë:

Neni I

Përkufizimet dhe interpretimi

Seksioni 1.01. Përkufizimet

a) Përveç nëse përkufizohen në paragrafin “b” më poshtë dhe përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe që përcaktohen në Marrëveshjen e Huas dhe Kushtet Standarde të BERZH-it të datës 5 nëntor 2021 do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje, me qëllim shmangien e dyshimit.

b) Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulat, shtojcat dhe skedulet), përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Ditë Pune” do të thotë një ditë (përveç së shtunës ose së dielës) kur bankat tregtare janë të hapura për biznes në përgjithësi (duke përfshirë transaksionet në valutë të huaj dhe depozitat në valutë të huaj) në Londër, Angli, dhe e cila është një Ditë e funksionimit të sistemit TARGET.

“Konsulent” do të thotë secili konsulent me kualifikime dhe reputacion të mirë i angazhuar (ose që do të angazhohet) nga Subjekti i Projektit, në lidhje me prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës.

“Kontratë Konsulence” do të thotë secila marrëveshje e lidhur (ose që do të lidhet) ndërmjet Subjektit të Projektit dhe Konsulentit përkatës për ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in.

“Shërbime Konsulence” do të thotë shërbimet që do të ofrohen nga secili Konsulent në lidhje me Projektin, të cilat do të përfshijnë mbështetjen për zbatimin e projektit, mbikëqyrjen e ndërtimit dhe monitorimin e punimeve të ndërtimit (**Zbatimi i Projektit dhe Mbikëqyrja e Punimeve**), siç përshkruhen më tej hollësisht në Termat e Referencës, të përcaktuara në Kontratën përkatëse të Konsulencës.

“Sistem i zbulimit të hershëm dhe i përjashtimit” do të thotë sistemet e vendosura me Rregulloren (BE, Euratom) nr. 2015/1929 të datës 28 tetor 2015 për rregullat financiare të zbatueshme ndaj buxhetit të përgjithshëm të Unionit (OJ L 286/1, 30.10.2015), ku përfshihet informacioni për zbulimin e hershëm të rreziqeve që kërcënojnë interesat financiarë të BE-së, për rastet e përjashtimit nga financimi i BE-së i personave juridikë dhe fizikë dhe për rastet e vendosjes së penaliteteve financiare.

“Politika dhe procedurat e zbatimit” do të thotë Politika dhe Procedurat e Zbatimit të BERZH-it të datës 4 tetor 2017, me ndryshimet e herëpashershme, dhe çdo politikë ose procedurë e miratuar nga BERZH-i si pasuese ose zëvendësuese e kësaj politike dhe këtyre procedurave.

“Masat kufizuese të BE-së” do të thotë masat kufizuese të miratuara sipas Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) ose Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

“Subjekt i përjashtuar” do të thotë një subjekt:

a) që ka qenë objekt i një vendimi të formës së prerë (një vendim që ka fuqinë e *res judicata*) ose një vendimi përfundimtar administrativ (një vendim i një autoriteti administrativ me efekt përfundimtar dhe detyrues sipas ligjit të zbatueshëm) për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash, vepra të lidhura me terrorizmin, punësim të fëmijëve ose trafikimin e qenieve njerëzore, shmangie tatimore, mashtrim tatimor dhe evazion fiskal, ose për një parregullsi që cenon interesat financiarë të BE-së;

b) që është fajtor për paraqitjen e dokumentacionit të rremë lidhur me informacionin që kërkohet si kusht për pjesëmarrjen në Grant, ose për mosdhënien e këtij informacioni.

“Fond” ka kuptimin e përcaktuar në preambulën (C).

“Grant” ka kuptimin e përcaktuar në seksionin 2.01(a) (*Shuma dhe qëllimi*).

“Zërat e Financuar nga Granti” do të thotë Shërbimet e Konsulencës të nevojshme për Projektin dhe të financuara tërësisht ose pjesërisht nga Granti, siç përshkruhet më tej në skedulin 1 (*Zërat e Financuar nga Granti*).

“IPAM” do të thotë Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit pranë BERZH-it, siç përcaktohet në Politikën e Llogaridhënies së Projektit të prillit 2019, i ndryshuar, plotësuar ose i zëvendësuar herë pas here.

“Marrëveshje e Huas” ka kuptimin e përcaktuar në preambulën A.

“Hua” ka kuptimin e përcaktuar në preambulën A.

“OLAF” do të thotë Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit e mandatuara nga Bashkimi Evropian.

“Pagesë” do të thotë disbursimi i një pjese të Grantit herë pas here në përputhje me seksionin 2.02 (*Pagesat e Grantit*).

“Kërkesa për pagesë” do të thotë një Kërkesë për Pagesë, në formën e shtojcës A (*Forma e Kërkesës për Pagesë*) dhe me përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, e dorëzuar te BERZH-i në përputhje me seksionin 2.02(a) (*Pagesat e Grantit*).

“Politikat dhe Rregullat e Prokurimit” do të thotë rregullat e prokurimit për operacionet e sektorit publik sipas Politikave dhe Rregullave të Prokurimit për Projektet e Financuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të ndryshuara herë pas here.

“Praktika e ndaluar” ka kuptimin që i jepet këtij termi në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

“Projekt” ka kuptimin e përcaktuar në preambulën A.

“Marrëveshje Projektit” ka kuptimin e përcaktuar në preambulën B.

“Përfaqësues i Autorizuar i Subjektit të Projektit” do të thotë Administratori i Subjektit të Projektit.

“Përfaqësues i Autorizuar i Marrësit” do të thotë ministri i Financave i Marrësit, përveç përcaktimit në seksionin 2.02(a).

“Rast Rimbursimt” do të thotë çdo rast ose ndodhi e specifikuar në Seksionin 6.03 (*Rastet e Rimbursimit*).

“Person i Kufizuar” do të thotë çdo subjekt, individ ose grup individësh të përcaktuar nga BE-ja si objekt i Masave Kufizuese të BE-së.

“Tatim” do të thotë çdo tatim, tarifë shfrytëzimi, taksë ose detyrim tjetër, vlerësim, tarifë, pagesë, tatim mbi vlerën e shtuar ose detyrim i çdo natyre tjetër (duke përfshirë çdo gjobë ose interes të lidhur) të vendosur sipas ndonjë ligji.

“Termat e Referencës” do të thotë dokumenti që përshkruan Shërbimet e Konsulencës që do të ofrohen nga Konsulenti në lidhje me Projektin, duke përfshirë, kur është e nevojshme, metodat dhe burimet që do të përdoren nga Konsulenti dhe/ose rezultatet që do të arrihen, të cilat do të jenë të pranueshme për BERZH-in, dhe do të bashkëlidhen në Kontratën përkatëse të Konsulencës.

“Sanksionet e OKB-së” do të thotë masat kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargot e armëve të vendosura ose administruara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë ato të publikuara në faqen zyrtare të OKB-së <https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/information>, të ndryshuara dhe plotësuara herë pas here apo në çdo faqe që zëvendëson atë.

Seksioni 1.02. Interpretimi

Në këtë Marrëveshjeje:

a) fjalët që tregojnë njëjës në përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe;

b) titujt dhe tabela e përmbajtjes janë përfshirë për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporatat, partneritetet dhe personat e tjerë juridikë dhe referencat për një person përfshijnë pasuesit e tij dhe drejtëmarrësit e lejuar;

d) referenca e një neni, seksioni, skeduli ose shtojce të veçantë do të interpretohet si referencë për atë nen ose seksion të veçantë apo skeduli ose shtojce të kësaj Marrëveshjeje;

e) çdo referencë për “ligj” do të thotë çdo ligj (duke përfshirë çdo ligj të thjeshtë ose zakonor) dhe çdo traktat, kushtetutë, statut, legjislacion, dekret, akt normativ, rregull, rregullore, gjykim, vendim, urdhër, vendim të ndërmjetëm, përcaktim, vendim i formës së prerë ose masë tjetër legjislative ose administrative, ose vendim gjyqësor apo arbitrazhi në çdo juridiksion, i cili ka fuqinë e ligjit ose zbatimi i të cilit është në përputhje me praktikën e përgjithshme në atë juridiksion;

f) çdo referencë për një dispozitë të ligjit është një referencë për atë dispozitë, të ndryshuar apo risjellë në fuqi herë pas here; dhe

g) “kontroll” (duke përfshirë, me kuptime korrelative, termat “i kontrolluar nga” dhe “nën kontroll të përbashkët me”), siç përdoret në lidhje me personat, do të thotë zotërimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i autoritetit për të drejtuar ose marrë masa për drejtimin e menaxhimit dhe politikave të një personi të tillë, qoftë përmes pronësisë së aksioneve me të drejtë vote, me anë të kontratave, ose ndryshe.

Neni II Financimi i Grantit

Seksioni 2.01. Shuma dhe qëllimi

a) Sipas dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, BERZH-i bie dakord të sigurojë për Marrësin, nga burimet e Fondit, një grant në shumën deri 7,500,000 euro (“**Granti**”).

b) Granti do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të Zërave të Financuar nga Granti.

c) Granti do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të prokurimit të Shërbimeve të Konsulencës. Granti nuk mund të përdoret për të paguar ndonjë nga kostot e mëposhtme:

1. Koston e blerjes së tokës ose ndërtesave;
2. Detyrime, taksa dhe tarifa, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në tatimin mbi vlerën e shtuar që janë të rikuperueshme ose të zbritshme;
3. Kthimin e kapitalit;
4. Borxhet dhe kostot e shërbimit të borxhit;
5. Tarifat bankare;
6. Kostot e shkaktuara gjatë dhe në lidhje me pezullimin e zbatimit të Projektit (në tërësi ose pjesërisht); ose
7. Çdo kontribut në natyrë.

d) Sipas seksionit 6.03 (*Rastet e Rimbursimit*), Granti është i parimbursueshëm.

e) Marrësi dhe Subjekti i Projektit shprehimisht pranojnë dhe bien dakord që BERZH-i: i. nuk do të jetë i detyruar të rrisë shumën e Grantit të përcaktuar në seksionin 2.01(a), nëse kostoja e Shërbimeve të Konsulencës rritet gjatë realizimit të tyre, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe; dhe ii. nuk do të jetë i detyruar të kryejë Pagesat ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse Fondi ka fonde të mjaftueshme në dispozicion për këtë qëllim; dhe nëse iii. Granti pakësohet nga interesat negativë që zbatohen në llogarinë bankare ku mbahen burimet e Fondit.

Seksioni 2.02. Pagesat e Grantit

a) Në bazë të Seksionit 6.02 (*Pezullimi ose Anulimi nga BERZH-i*) dhe nenit III (*Kushtet për Pagesë*), BERZH-i do të disbursojë Grantin herë pas here në çdo Ditë Pune, në një ose më shumë Pagesa, sipas kërkesës së Marrësit. Marrësi mund të kërkojë një Pagesë duke dorëzuar te BERZH-i një Kërkesë për Pagesë, në format PDF-je, me *e-mail* tek ekipi i Llogarive të Pagueshme (APIInvoices@ebrd.com), si dhe te drejtuesi i operacionit (gulm@ebrd.com), të paktën 10 Ditë Pune para datës së propozuar të kësaj Pagese të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Subjektit të Projektit, ose një person i caktuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Subjektit të Projektit dhe çdo person i tillë duhet të jetë i caktuar si Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit, për qëllimet e këtij seksioni 2.02(a). Çdo dokument mbështetës që shoqëron Kërkesat për Pagesë do të jetë në gjuhën angleze. Përveç nëse BERZH-i bie dakord ndryshe, Kërkesa për Pagesë është e parevokueshme dhe detyruese për Marrësin.

b) Sipas Kontratës së Konsulencës që është në fuqi dhe efekt të plotë dhe përveç nëse BERZH-i bie dakord ndryshe me shkrim, BERZH-i do të disbursojë një parapagim për Konsulentin brenda 10 Ditësh Pune nga depozitimi prej Marrësit të Kërkesës për Pagesë bashkë me faturën e Konsulentit

për pagesën e paradhënies, si dhe një garanci bankare nga një bankë e njohur në të njëjtën valutë dhe shumë si pagesa e parapagimit, në secilin rast, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in.

c) Përveç nëse BERZH-i bie dakord ndryshe, asnjë Pagesë nuk do të kërkohet pas 31 dhjetorit 2030 dhe çdo pjesë e padisbursuar e Grantit do të anulohet automatikisht në ditën pasuese.

d) Përveç nëse BERZH-i bie dakord ndryshe, Pagesat do të kryhen vetëm në përputhje me Kontratën e Konsulencës për të financuar prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës.

e) Pagesat do të bëhen në euro në një shumë të barabartë ose ekuivalente me shpenzimet që do të financohen nga të ardhurat e Grantit. Në rastin e shpenzimeve të bëra në një valutë ose valuta të tjera përveç euros, shuma ekuivalente e Pagesës do të përcaktohet si më poshtë:

i. nëse Marrësi kërkon Pagesë në euro, shuma ekuivalente e Pagesës do të përcaktohet nga Banka në bazë të kursit të këmbimit të përcaktuar nga Banka sipas diskrecionit të saj; ose

ii. nëse Marrësi kërkon Pagesë në valutën ose valutat e shpenzimeve, Banka do të blejë atë valutë ose ato valuta në mënyrën që Banka e çmon të përshtatshme, me kusht që ato shpenzime të jenë në valuta lehtësisht të disponueshme. Shuma ekuivalente e Pagesës do të përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit që i shkaktohen ose do t'i ishin shkaktuar Bankës nga përdorimi i euros për të përmbushur kërkesën.

Seksioni 2.03. Pagesat

a) Përveç nëse BERZH-i bie dakord ose kërkon ndryshe, shumat që do të disbursohen nga BERZH-i sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e Konsulentit, siç përcaktohet në faturën përkatëse (rreziku dhe shpenzimet për çdo transferim Pagesë në llogarinë e Konsulentit do të jenë në ngarkim të Subjektit të Projektit). BERZH-i do të kryejë pagesat vetëm nëpërmjet pagesave elektronike në një llogari bankare në emrin e Konsulentit dhe që ndodhet ose në vendin e shoqërisë së Konsulentit, ose në vendin e tij të banimit, ose në vendin ku kryhen Shërbimet e Konsulencës (me pëlqimin paraprak të BERZH-it).

b) Nëse data e caktuar për çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bie në një ditë që nuk është Ditë Pune, pagesa në fjalë do të kryhet në Ditën pasuese të Punës.

c) Çdo shumë që duhet paguar nga BERZH-i sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet, pa zbritje ose kundërpretendim, nga fondet e gatshme në euro, në vlerën dhe datën e kërkuar, në një llogari që e cakton BERZH-i herë pas here dhe ia zbulon Marrësit. Të gjitha pagesat për BERZH-n, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të jenë të lira dhe pa asnjë zbritje ose mbajtje në lidhje me ndonjë taksë, detyrim, tarifë ose barrë të çfarëdo natyre. Asnjë pagesë nuk do të konsiderohet e bërë për BERZH-in sipas kësaj Marrëveshjeje derisa të mbërrijë e plotë, pa asnjë zbritje dhe pa asnjë bllokim, në një llogari ose vend tjetër të specifikuar në këtë paragraf “c”. Në rast se ndonjë pagesë që Marrësi pretendon se e ka bërë, ndalohet, kufizohet, ose vonohet për shkak të ndonjë ndërhyrjeje ose veprimi tjetër që lidhet me sanksione ose masa kufizuese, Marrësi është përgjegjës për pagesën që i detyrohet BERZH-it derisa pagesa në fjalë të bëhet sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.04. Taksat dhe detyrimet

a) Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të paguajnë, kur është e nevojshme, të gjitha Taksat që vendosen mbi të dhe që duhen paguar në lidhje me nënshkrimin, lëshimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë dokument tjetër lidhur me këtë Marrëveshje.

b) Marrësi dhe Subjekti i Projektit pranojnë dhe bien dakord që asnjë pjesë e të ardhurave të Grantit nuk do të përdoret, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për pagesën e ndonjë Takse, qoftë direkte apo indirekte, në Shqipëri ose diku tjetër.

c) Nëse në lidhje me Kontratën e Konsulencës duhet paguar ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në):

i. Marrësi ose Subjekti i Projektit do të informojë BERZH-in sa më shpejt që të jetë e mundur;

ii. Marrësi ose Subjekti i Projektit do t'i paguajë një shumë të barabartë me çdo taksë indirekte (përfshirë TVSH-në) drejtpërdrejt Konsulentit; dhe

iii. në çdo Kërkesë për Pagesë, Marrësi do të vërtetojë që ai ose Subjekti i Projektit ka paguar ose do të paguajë një shumë të barabartë me çdo taksë indirekte në faturat e mëparshme të Konsulentit dhe do të marrë përsipër të paguajë Tatimin indirekt (përfshirë TVSH-në) në faturën aktuale.

Seksioni 2.05. Ndarja e kostove

a) Pagesa nga Marrësi e çdo takse dhe e të gjitha taksave indirekte, sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 2.04 (*Taksat dhe Detyrimet*), duke përfshirë TVSH-në, nëse është rasti, do të konsiderohet si kontribut i Marrësit në ndarjen e kostove.

b) Marrësi do të paguajë shumën e specifikuar në skedulin 2 (*Kategoritë dhe Tërheqjet*) të Marrëveshjes së Huas nga të ardhurat e Huas për kostot e Shërbimeve të Konsulencës.

Neni III

Kushtet paraprake

Seksioni 3.01. Pagesa e parë e Grantit

Detyrimi i BERZH-it për të kryer Pagesën e parë të Grantit do të jetë në varësi të përmbushjes më parë, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, ose heqjes dorë prej kushteve të mëposhtme paraprake:

a) BERZH-i duhet të ketë marrë dy origjinale të nënshkruara sipas rregullave, të kësaj Marrëveshjeje;

b) Duhet të ketë ndodhur Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Huas;

c) BERZH-i duhet të ketë marrë një certifikatë të detyrës dhe autoritetit të Subjektit të Projektit, kryesisht në formën e shtojcës B (*Formulari i Certifikatës së Detyrës dhe Autoritetit*);

d) BERZH-i duhet të ketë marrë një kopje të certifikuar të secilës Kontratë Konsulence të nënshkruar;

e) BERZH-i duhet të ketë marrë një opinion ligjor nga këshilltari juridik i brendshëm i Subjektit të Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, në lidhje me këtë Marrëveshje, ku të specifikohet që kjo Marrëveshje është autorizuar sipas rregullave, nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Subjektit të Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm, ligjërish të detyrueshëm për Subjektin e Projektit, dhe do të zbatohet në përputhje me dispozitat e saj;

f) BERZH-i duhet të ketë marrë nga Marrësi njoftim me shkrim në lidhje me përfundimin e të gjitha procedurave të kërkuara për hyrjen në fuqi dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duke konfirmuar miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe se të gjitha kërkesat e ligjit shqiptar për të siguruar vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

Seksioni 3.02. Të gjitha pagesat e Grantit

Detyrimi i BERZH-it për të kryer ndonjë nga Pagesat e Grantit do të jetë, gjithashtu, në varësi të përmbushjes, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, ose heqjes dorë nga kushtet që kërkojnë që në datën e kërkesës së Marrësit për këtë Pagesë dhe në datën e Pagesës në fjalë:

a) Marrëveshja e Huas dhe Marrëveshja e Projektit duhet të jenë në fuqi dhe efekt të plotë dhe si Marrësi, ashtu dhe Subjekti i Projektit duhet të jenë në pajtim me të gjitha detyrimet e tyre sipas Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Projektit;

b) të gjitha kushtet paraprake për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas duhet të jenë përmbushur, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, ose, nëse është rasti, BERZH-i të ketë hequr dorë prej tyre sipas diskrecionit të tij absolut;

c) përfaqësimet dhe garancitë e dhëna ose të konfirmuara nga Marrësi dhe Subjekti i Projektit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, në datën e nënshkrimit të saj, duhet të jenë të vërteta në datën e Pagesës dhe të kenë të njëjtin efekt sikur të ishin bërë në këtë datë të fundit;

d) asnjë nga rastet e përshkruara në seksionin 6.02(a) (*Pezullimi ose Anulimi nga BERZH-i*) nuk duhet të ketë ndodhur dhe të jetë në vazhdim;

e) Marrësi ose Subjekti i Projektit nuk duhet, si rezultat i Pagesave të tilla, të shkelin dokumentet statutore dhe ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë, dispozitat e marrëveshjeve ose të instrumenteve ku Marrësi ose Subjekti i Projektit janë palë (përfshirë këtë Marrëveshje), ose që janë të detyrueshme për Marrësin ose Subjektin e Projektit apo ligjet e zbatueshme për Marrësin ose Subjektin e Projektit;

f) asgjë nuk duhet të ketë ndodhur që, sipas opinionit të arsyeshëm të BERZH-it, mund të ketë efekt material negativ mbi Marrësin, Subjektin e Projektit ose Projektin;

g) BERZH-i duhet të ketë marrë Kërkesën për Pagesë nga Marrësi në kohë;

h) BERZH-i duhet të ketë marrë një kopje të secilës faturë për të cilën kërkohet Pagesa;

i) BERZH-i duhet të ketë marrë konfirmimin e Subjektit të Projektit, që:

i. përveç Pagesës së parapagimit, Shërbimet e Konsulencës janë ofruar ose kryer në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës përkatëse të Konsulencës;

ii. secila faturë është e drejtë dhe e saktë dhe korrespondon me shumat e përcaktuara në Kontratën përkatëse të Konsulencës; dhe

j) BERZH-i duhet të ketë marrë edhe dokumente të tjera që BERZH-i mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, duke përfshirë: i. prova për përdorimin e propozuar të të ardhurave të Pagesës; dhe ii. prova për përdorimin e të ardhurave të çdo Page/ave të mëparshme.

Neni IV

Detyrimet e marrësit dhe të subjektit të projektit

Përveç nëse BERZH bie dakord ndryshe me shkrim:

Seksioni 4.01. Zhvillimi i operacioneve

Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet të zhvillojnë biznesin dhe operacionet e tyre në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe me praktikën e qëndrueshme financiare, teknike dhe tregtare.

Seksioni 4.02. Përdorimi i Grantit

Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet ta përdorin Grantin në mënyrë rigorozë dhe vetëm për të financuar prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës.

Seksioni 4.03. Njësia e Zbatimit të Projektit

Subjekti i Projektit duhet të përmbushë detyrimet e tij sipas seksionit 2.03 të Marrëveshjes së Projektit, për krijimin dhe funksionimin, gjatë kohës së zbatimit të Projektit, e Njesisë së Zbatimit të Projektit me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar, në nivel të pranueshëm për Bankën.

Seksioni 4.04. Prokurimi

a) Subjekti i Projektit duhet të garantojë që Shërbimet e Konsulencës të prokurohen në përputhje me Politikën dhe Rregullat e Prokurimit.

b) Çdo Kontratë Konsulente do t'u nënshtrohet procedurave të rishikimit të përcaktuara në Politikën dhe Rregullat e Prokurimit dhe rishikimit paraprak nga BERZH-i.

c) Nëse, në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, BERZH-i përcakton që Marrësi, Subjekti i Projektit, një furnizues, nënfurnizues, kontraktor, nënkontraktor, koncesionar, konsulent ose nënkonsulent në fazën e konkurrimit ose të ekzekutimit të ndonjë marrëveshjeje, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratave të Konsulencës, ose ndonjë nga transaksionet e parashikuara në to, përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndalar, BERZH-i mund ta shpallë një marrëveshje të tillë të

papranueshme për financim, si dhe BERZH-i mund të ndërmarrë çdo Veprim Detyrues dhe çdo Veprim për Zbulimin (sipas kuptimit të këtyre termave në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit).

d) Subjekti i Projektit duhet të garantojë që Konsulenti dhe nënkontraktorët e tij, nëse ka, të mos jenë në kategorinë e Subjekteve të Përgjashtuara.

Seksioni 4.05. Kontratat e Konsulencës

a) Subjekti i Projektit duhet:

i. të sigurojë që Kontrata e Konsulencës të parashikojë dorëzimin e të gjitha Shërbimeve të Konsulencës deri më 31 dhjetor 2030;

ii. të sigurojë që të gjitha Kontratat e Konsulencës të përfshijnë dispozita të pranueshme për BERZH-in që kërkojnë që Konsulenti dhe kontraktorët dhe nënkontraktorët e tij të mos përfshihen në ndonjë Praktikë të Ndalar, siç përcaktohet në seksionin 4.08 (*Mashtrimi dhe Korrupsioni*) dhe seksionin 4.11 (*Inspektimi dhe Auditimi*); dhe

iii. t'i sigurojë BERZH-it një kopje të secilës Kontratë Konsulencë të nënshkruar jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të saj.

b) Subjekti i Projektit nuk duhet të bëjë asnjë ndryshim material (duke përfshirë çdo modifikim material ose heqje dorë nga termat dhe kushtet, zgjatjen e afatit të caktuar për realizimin e kontratës, çdo rritje të shumës totale të kontratës, duke përfshirë kontingjencat) ose të marrë ndonjë vendim lidhur me caktimin, nënkontraktimin, pezullimin ose ndërprerjen e ndonjëres prej Kontratave të Konsulencës pa pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it (i cili nuk do të tërhiqet pa arsye).

Seksioni 4.06. Dokumentacioni financiar dhe raportet financiare

Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet:

a) të mbajnë libra të veçantë të llogarive dhe dokumente të tjera në lidhje me Grantin, në përputhje me standardet e kontabilitetit, të pranueshme për BERZH-in dhe të zbatuara në vijimësi.

b) të mbajnë të gjitha informacionet financiare të rëndësishme, dokumentet dhe llogaritë që lidhen me Grantin për të identifikuar çdo shërbim të financuar nga të ardhurat e Grantit dhe për të identifikuar përdorimin e tyre në Projekt, për jo më pak se pesë vjet pas:

1. Datës së përfundimit ose ndërprerjes të Kontratës së Konsulencës; dhe

2. Nëse ka filluar një auditim ose hetim nga OLAF-i ose Banka në lidhje me Projektin, pas datës kur një auditim ose hetim i tillë përfundon,

dhe Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet të bëjnë të mundur, ndërsa Subjekti i Projektit do të marrë masa që edhe Konsulentët t'i vënë këto informacione, dokumente dhe llogari në dispozicion të përfaqësuesve të Bankës, me kërkesë të Bankës.

Seksioni 4.07. Furnizimi me Informacione

a) Marrësi dhe Subjekti i Projektit pranojnë që informacionet që i dërgojnë BERZH-it sipas Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Projektit, BERZH-i mund t'i përdorë dhe të bazohet në çdo informacion të tillë të dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në rastet kur informacioni në vijim nuk i është dërguar BERZH-it sipas Marrëveshjes së Huas, Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet t'ia sigurojnë BERZH-it, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in:

i. informacionin e detajuar në lidhje me prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës, Kontratat e Konsulencës, Konsulentët dhe përdorimin e Grantit;

ii. informacionin e mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi BERZH-it të ndjekë përdorimin e Grantit (në dallim nga Huaja); dhe

iii. menjëherë sapo të vihet në dijeni për ndodhjen e ndonjë Praktike të Ndalar që përfshin Konsulentin dhe/ose furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët e tij, Subjekti i Projektit duhet të njoftojë BERZH-in, duke specifikuar natyrën e një rasti të tillë dhe çdo hap që Marrësi është duke ndërmarrë për të zgjidhur këtë situatë;

iv. informacione të tjera në lidhje me Marrësin, Subjektin e Projektit, Projektin dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje që BERZH-i mund t'i kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

c) Sapo të jenë të disponueshme, por në çdo rast jo më vonë se 28 shkurti i çdo viti kalendarik, raportin e zbatimit dymbëdhjetëmujor që përfundon më 31 dhjetor të vitit përkatës, i cili përmban një narrativë dhe të dhëna financiare në lidhje me Shërbimet e Konsulencës që janë ofruar për periudhën përkatëse, në formatin e kërkuar nga BERZH-i.

d) Sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda 60 ditëve pas përfundimit të Projektit, Subjekti i Projektit duhet t'i dërgojë BERZH-it raportin përfundimtar në lidhje me Projektin, duke identifikuar përdorimin e Grantit.

e) Menjëherë pas ndodhjes së ndonjë prej rasteve të përshkruara në seksionin 6.02(a) (*Pezullimi ose Anulimi nga BERZH-i*), Marrësi ose Subjekti i Projektit duhet të njoftojë BERZH-in, duke specifikuar natyrën e një rasti të tillë dhe çdo hap që Marrësi ose Subjekti i Projektit është duke ndërmarrë për të zgjidhur rastin.

f) Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet të njoftojnë menjëherë BERZH-in, nëse Marrësi dhe Subjekti i Projektit marrin informacion në lidhje me shkeljet e parashikuara në seksionin 4.08 (*Mashtrimi dhe Korrupsioni*) ose seksionin 5.01(b) (*Dokumentacioni*) ose kur ndonjë institucion financiar ndërkombëtar vendos sanksione ndaj Marrësit ose Subjektit të Projektit për ndonjë Praktikë të Ndaluar. Nëse BERZH-i njofton Marrësin ose Subjektin e Projektit për shqetësimin e tij lidhur me ndonjë shkelje të seksionit 4.09 ose 5.01(b), Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet të bashkëpunojnë në mirëbesim me BERZH-in dhe përfaqësuesit e tij, për të përcaktuar nëse një shkelje e tillë ka ndodhur.

g) Subjekti i Projektit duhet të njoftojë menjëherë BERZH-in për pezullimin, ndërprerjen, caktimin ose nënkontraktimin, ose çdo ndryshim në ndonjë nga Kontratat e Konsulencës, duke përfshirë, por pa u kufizuar te ndryshimet e përmendura në seksionin 4.05(b), ose ndonjë rast që mund të çojë në vonesën e realizimit të Shërbimeve të Konsulencës.

h) Marrësi dhe Subjekti i Projektit duhet të furnizojnë menjëherë BERZH-in me informacione të tjera që BERZH-i ose Fondi mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme herë pas here.

Seksioni 4.08. Mashtrimi dhe Korrupsioni

a) Marrësi ose Subjekti i Projektit nuk do të angazhohen dhe nuk do të autorizojnë ose lejojnë ndonjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit e tyre, ose Konsulentët që të angazhohen në ndonjë nga Praktikët e Ndaluara në lidhje me Projektin, këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat e Konsulencës.

b) Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, Marrësi dhe Subjekti i Projektit pranojnë që BERZH-i ka të drejtë ta shpallë këtë Marrëveshje të papranueshme për financim dhe se BERZH-i mund të zbatojë Politikën dhe Procedurat e Zbatimit dhe të ndërmarrë çdo Veprim Detyrues ose Veprim Zbulimi (sipas përkufizimit të këtyre termave në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit) në lidhje me akuzat për Praktikë të Ndaluara në kuadrin e Projektit, kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë transaksioni të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat e Konsulencës dhe Shërbimet e Konsulencës.

c) Subjekti i Projektit do të përfshijë dispozitat e mëposhtme në të gjitha dokumentet e tenderit dhe kontratat e lidhura me Kontratat e Konsulencës dhe Shërbimet e Konsulencës:

i. të cilat përcaktojnë se furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët nuk do të angazhohen dhe nuk do të autorizojnë ose lejojnë ndonjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit e tyre që

të angazhohen në ndonjë Praktikë të Ndaluar në lidhje me Projektin ose transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat e Konsulencës dhe Shërbimet e Konsulencës; dhe

ii. të cilat vënë në dijeni furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët që BERZH-i mund ta shpallë këtë Marrëveshje të papranueshme për financim dhe se BERZH-i mund të zbatojë Politikën dhe Procedurat e Zbatimit dhe të ndërmarrë çdo Veprim Detyrues dhe Veprim Zbulimi (sipas përkufizimit të këtyre termave në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit), në lidhje me akuzat për Praktika të Ndaluar në kuadrin e Projektit ose ndonjë transaksioni të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat e Konsulencës dhe Shërbimet e Konsulencës.

Seksioni 4.09. Puna e fëmijëve

Subjekti i Projektit do të sigurojë që Projekti të jetë gjithmonë në përputhje me kërkesat në lidhje me punën e fëmijëve ose trafikimin e qenieve njerëzore, siç përcaktohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, veçanërisht në Kërkesën e Performancës 2: Puna dhe Kushtet e Punës.

Seksioni 4.10. Vizibiliteti

a) Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të marrin masat e duhura për të bërë publike në publikimet përkatëse, komunikimet, si dhe në media, faktin që Projekti ka marrë financim, ndër të tjera, nga Fondi.

b) Emri, akronimi dhe logoja e BERZH-it janë marka shërbimi të regjistruara, të cilat Marrësi dhe Subjekti i Projektit nuk duhet t'i riprodhojnë pa lejen e shprehur me shkrim të BERZH-it.

c) Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të sigurojnë që të gjitha raportet e bëra herë pas here në lidhje me përdorimin e Grantit, të përfshijnë tekstin e mëposhtëm:

“Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor si pjesë e Programit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Përkëmbjet e shprehura në këtë raport i përkasin [Marrësit / Subjektit të Projektit] dhe për këtë arsye nuk mund të merren si opinion i zyrtar i kontribuesve në Fondin e Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, BERZH-it ose Bankës Evropiane të Investimeve si bashkëmenaxherë të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor.”

d) Marrësi dhe Subjekti i Projektit marrin përsipër që së bashku me Konsulentin të bashkëpunojnë në mirëbesim me BERZH-in dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për të rënë dakord për një plan komunikimi dhe vizibiliteti për publikun vendës si dhe audiencën ndërkombëtare, i cili identifikon qëllimet dhe përfitimet e Projektit dhe financimit të tij, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in.

Seksioni 4.11. Inspektimi dhe Auditimi

a) Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të lejojnë Bankën, Komisionin Evropian, OLAF-in, Gjykatën Evropiane të Audituesve ose çdonjërin nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar për të kontrolluar nga zyra, si dhe për inspektuar në vend, përdorimin e Grantit. Për këtë qëllim, si Marrësi edhe Subjekti i Projektit do të bëjnë të mundur që Banka, Komisioni Evropian, OLAF-i, Gjykata Evropiane e Audituesve ose ndonjë nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar, me paraqitjen e kërkesës:

i. të vizitojnë çdo objekt dhe vend që lidhet me Projektin ose ndonjë nga ambientet e tjera ku kryhet biznesi i Marrësit dhe i Subjektit të Projektit, në kuadrin e çdo verifikimi, misioni vlerësimi dhe/ose hetimi (përfshirë kontrollin në vend) lidhur me ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës;

ii. t'u vihen në dispozicion dhe të inspektojnë të gjitha pronat, librat, llogaritë, dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara që lidhen me Projektin, këtë Marrëveshje ose transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat e Konsulencës dhe Shërbimet e Konsulencës;

iii. të lejohen audituesit e emëruar nga BERZH-i që të auditojnë këto libra, llogari, dokumente; dhe

iv. t'u mundësohen atyre takime dhe diskutime me përfaqësuesit dhe punonjësit e Marrësit dhe Subjektit të Projektit, sa herë që BERZH-i ta çmojë të nevojshme dhe të përshtatshme,

në secilin rast, me qëllim që: 1. Të lehtësohet monitorimi dhe vlerësimi i BERZH-it për Projektin dhe përdorimin e Grantit dhe t'i jepet mundësia BERZH-it që të shqyrtojë dhe trajtojë çdo kërkesë

lidhur me Projektin drejtuar IPAM-it; si dhe 2. Të vlerësojë nëse ka pasur ndonjë Praktikë e Ndaluar në lidhje me Projektin, me këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat e Konsulencës dhe Shërbimet e Konsulencës.

b) Subjekti i Projektit do të sigurojë që në të gjitha dokumentet e tenderit dhe të gjitha kontratat e lidhura në kuadrin e Kontratave të Konsulencës të përfshihen dispozita me efektin e paragrafit “a” më sipër, për sa u takon furnizuesve, nënfurnizuesve, kontraktorëve, nënkontraktorëve, koncesionarëve, konsulentëve dhe nënkonsulentëve.

Neni V

Përfaqësimet dhe garancitë

Seksioni 5.01. Përfaqësimet

a) Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë e paraqitura nga Marrësi, në cilësinë e tij si Huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas dhe nga Subjekti i Projektit sipas Marrëveshjes së Projektit, duhet të përsëriten nga Marrësi dhe Subjekti i Projektit si të ishin parashikuar plotësisht këtu.

b) Marrësi dhe Subjekti i Projektit më tej garantojnë dhe i dokumentojnë BERZH-it që:

i. Subjekti i Projektit nuk është Subjekt i Përgjashtuar;

ii. As Subjekti i Projektit, as ndonjë subjekt ose person me të cilin ai ose Marrësi ka ose pritët të ketë marrëdhënie kontraktuale të drejtpërdrejtë në lidhje me zbatimin e Projektit dhe që do të marrë Grantin, nuk është Person i Kufizuar;

iii. As Marrësi, as Subjekti i Projektit dhe as ndonjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit e tyre përkatës nuk kanë kryer, as nuk janë angazhuar në ndonjë Praktikë të Ndaluar dhe/ose aktivitet tjetër të paligjshëm që mund të ndikojë tek interesat financiarë të Fondit, në kuadër të Projektit, të kësaj Marrëveshjeje ose transaksioni të parashikuar nga kjo Marrëveshje.

c) Marrësi dhe Subjekti i Projektit më tej i garantojnë dhe dokumentojnë BERZH-it që:

i. janë në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit;

ii. as Subjekti i Projektit dhe as Konsulenti nuk janë: i. të përcaktuar si objekt i ndonjë Sanksioni të OKB-së; ose ii. nuk zotërohen (drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose pjesërisht) ose kontrollohen nga persona të përcaktuar si të tillë, ose që veprojnë në emër të tyre;

iii. asnjë pjesë e Shërbimeve të Konsulencës nuk është objekt dhe as nuk ndalohet si pasojë e ndonjë Sanksioni të OKB-së dhe Marrësi nuk është i angazhuar në asnjë formë (drejtpërdrejt ose tërthorazi) në ndonjë operacion që shkel Sanksionet e OKB-së; dhe

iv. as Marrësi, as Subjekti i Projektit dhe as Konsulenti nuk janë objekt i ndonjë rregulloreje ose ligji (përfshirë sanksionet dhe masat kufizuese) që kanë ose priten të kenë efektin e ndalimit, kufizimit ose vonimit, në aspektin material, të ndonjë Pajese që BERZH-i ose Marrësi është i detyruar të kryejë sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

d) Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të: 1. Njoftojnë menjëherë BERZH-in nëse marrin informacion në lidhje me pasaktësinë e ndonjë dokumenti ose vërtetimi të përcaktuar në paragrafët “b” dhe “c” më sipër; dhe 2. Do të bashkëpunojnë në mirëbesim me BERZH-in dhe përfaqësuesit e tij për të vlerësuar nëse ka pasur shkelje të tillë dhe do të përgjigjen menjëherë dhe me detaje të arsyeshme për çdo kërkesë nga BERZH-i, në lidhje me një shkelje të tillë të pretenduar dhe me kërkesën e BERZH-it, do të dorëzojnë provat dokumentuese për përgjigjen e dhënë.

Seksioni 5.02. Pranimi dhe përsëritja

a) Si Marrësi edhe Subjekti i Projektit pranon se ka paraqitur dhe përsëritur përfaqësimet dhe garancitë që përmenden në seksionin 5.01 (*Dokumentet*), me qëllimin për të bindur BERZH-in që të

lidhë këtë Marrëveshje dhe të ofrojë Grantin. Gjithashtu, pranojnë se BERZH-i ka lidhur këtë Marrëveshje, duke u bazuar dhe besuar plotësisht te secili prej përfaqësimeve dhe garancive. Si Marrësi edhe Subjekti i Projektit garanton që nuk ka dijeni për ndonjë fakt ose çështje shtesë, mospërmendja e të cilave i bën këto përfaqësime dhe garanci të gabuara.

b) Përfaqësimet dhe garancitë e dhëna në seksionin 5.01 (*Dokumentet*) do të konsiderohen të përsëritura me paraqitjen e çdo Kërkese për Pagesë dhe në datën e Pagesës, përveç dokumenteve ose garancive që përcaktojnë se janë paraqitur “në datën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.”

Neni VI Pezullimi dhe anulimi

Seksioni 6.01. Anulimi nga Marrësi

Marrësi mund të anulojë në çdo kohë, me jo më pak se 40 ditë njoftim paraprak me shkrim për BERZH-in, të gjithë ose një pjesë të Grantit të padisbursuar, me kusht që BERZH-i të krijojë bindjen që Marrësi do të ketë në dispozicion financim të mjaftueshëm për të përfunduar Projektin. Çdo njoftim për anulim nga Marrësi do të jetë i parevokueshëm dhe detyrues, dhe shumat e Grantit të anuluar nga Marrësi nuk mund të merren.

Seksioni 6.02. Pezullimi ose anulimi nga BERZH-i

a) BERZH-i ka të drejtë t'i paraqesë njoftim me shkrim Marrësit për pezullimin ose anulimin e së drejtës së Marrësit për të kërkuar të gjithë ose një pjesë të Grantit të padisbursuar, nëse ndonjë nga rastet e mëposhtme ka ndodhur dhe është në vijim:

i. BERZH-i ka pezulluar disbursimet ose ka anuluar të gjithë ose ndonjë pjesë të Huas, ose BERZH-i ka të drejtë të pezullojë disbursimet ose të anulojë të gjithë ose ndonjë pjesë të Huas sipas Marrëveshjes së Huas;

ii. Marrëveshja e Huas ose Marrëveshja e Projektit pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë ose përfundon;

iii. Marrësi ose Subjekti i Projektit nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

iv. informacioni i përfshirë në një Kërkese për Pagesë është i pavërtetë, i pasaktë ose përmban mashtrim në ndonjë aspekt material;

v. ndonjë nga Kontratat e Konsulencës nuk është përfunduar, ose pezulluar ose ndërprerë;

vi. Marrësi ka anuluar të gjithë ose ndonjë pjesë të padisbursuar të Huas;

vii. ndonjë rast përshpejtues i përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ka ndodhur dhe është në vijim dhe BERZH-i ka shpallur të gjithë ose ndonjë pjesë të Huas si të kërkueshme dhe të pagueshme;

viii. është siguruar financim alternativ për Projektin, duke sjellë financim të dyfishtë (qoftë në tërësi ose pjesërisht);

ix. kontribuesit e Fondit kanë tërhequr financimin nga Fondi;

x. në ndonjë nga juridiksionet e BERZH-it është ose është bërë e paligjshme që BERZH-i të bëjë, mbajë ose të financojë Grantin, ose të kryejë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

xi. nëse në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, BERZH-i ka përcaktuar që Marrësi, Subjekti i Projektit ose bashkëpunëtorët e tyre janë përfshirë në listën e BERZH-it për personat ose subjektet që nuk lejohen të fitojnë një kontratë të financuar nga BERZH-i ose ndalohen të marrin financim nga BERZH-i, sipas listës që mund të gjendet në faqen e internetit të BERZH-it;

xii. ka ndodhur një rast ose ka gjasa të ndodhë një i tillë, e cila sipas mendimit të arsyeshëm të BERZH-it, ka gjasa të ndikojë ose të vonojë në mënyrë të konsiderueshme realizimin e Shërbimeve të Konsulencës; ose

xiii. 1) Ndonjë dokument, garanci ose angazhim i bërë nga Marrësi ose Subjekti i Projektit, sipas paragrafëve “b”, “c” ose “d” të seksionit 5.01, ka qenë i pasaktë ose mashtrues ose është shkelur; ose 2) Ndonjë dokument ose garanci tjetër e bërë nga Marrësi ose Subjekti i Projektit, sipas ose lidhur me këtë Marrëveshje ka qenë e pasaktë ose mashtruese në ndonjë aspekt material.

b) Pas dhënies së njoftimit për pezullim ose anulim nga BERZH-i, sipas paragrafit “a” më sipër, e drejta e Marrësit për të kërkuar Pagesa të mëtejshme do të pezullohet ose anulohet, siç përcaktohet në njoftim. Ushtrimi nga BERZH-i i së drejtës së pezullimit nuk do të pengojë BERZH-in të ushtrojë të drejtën e anulimit, siç përcaktohet në këtë seksion, qoftë për të njëjtën arsye ose për një arsye tjetër, dhe nuk do të kufizojë asnjë të drejtë tjetër të BERZH-it sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Projektit.

Seksioni 6.03. Rastet e Rimbursimit

a) Secili nga rastet e përshkruara në seksionin 6.02(a) (*Pezullimi ose Anulimi nga BERZH-i*) që ka ndodhur dhe është në vazhdim për një periudhë prej 30 ditësh pas njoftimit të dhënë nga BERZH-i, nëse ka mundësi riparimi, rasti do të përbëjë një Rast Rimbursimi.

b) Nëse ndodh dhe vazhdon një Rast Rimbursimi, BERZH-i me njoftim me shkrim mund të kërkojë që Marrësi të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Grantit (duke përfshirë, për shmangie të dyshimit, çdo pagesë paraprake të bërë) dhe të paguajë çdo shumë tjetër të akumuluar ose të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Pavarësisht nga çdo gjë në këtë Marrëveshje që thotë të kundërtën, shuma e kërkuar nga BERZH-i do të bëhet menjëherë: i. e maturuar dhe e pagueshme sipas kërkesës; ose ii. menjëherë e maturuar dhe e pagueshme pa ndonjë njoftim të mëtejshëm dhe pa ndonjë parashtrësë, kërkesë ose protestë të çfarëdo lloji, nga të cilat Marrësi dhe Subjekti i Projektit heqin dorë shprehimisht me anë të kësaj dispozite.

c) Pavarësisht nga ndonjë pikë për të kundërtën në këtë Marrëveshje: i. nëse në ndonjë kohë BERZH-i përcakton në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit që Marrësi, Subjekti i Projektit ose një Konsulent apo kontraktor gjatë konkurrimit apo ekzekutimit të Kontratës së Konsulencës, ose ndonjë kontrate të lidhur me të, angazhohet në një Praktikë të Ndaluar, BERZH-i mund t'i kërkojë me shkrim Marrësit që Marrësi të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Grantit dhe kjo shumë do të bëhet menjëherë e maturuar dhe e pagueshme sipas kërkesës; dhe/ose ii. BERZH-i, ose Komisioni Evropian, OLAF-i, ose Gjykata Evropiane e Auditorëve, në përputhje me seksionin 4.11 të kësaj Marrëveshjeje përcaktojnë që burimet e Fondit janë paguar në mënyrë të padrejtë, ose janë përdorur gabimisht nga Marrësi, Subjekti i Projektit ose Konsulenti, BERZH-i mund t'i kërkojë me shkrim Marrësit, që Marrësi të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Grantit dhe kjo shumë do të bëhet menjëherë e maturuar dhe e pagueshme sipas kërkesës, me kusht që shuma për t'u rimbursuar të jetë sa pjesa e Grantit që është përdorur në mënyrë të padrejtë ose jokorrekte.

d) Pavarësisht nga ndonjë pikë për të kundërtën në këtë Marrëveshje, nëse BERZH-i përcakton që ndonjë pjesë e të ardhurave të Grantit është përdorur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të bërë pagesa, ose për përfitimin e: i. një personi ose subjekti që është përcaktuar si objekt i ndonjë prej Sanksioneve të OKB-së ose Masave Kufizuese të BE-së; ose ii. një subjekt që zotërohet ose kontrollohet, ose që vepron në emër ose sipas urdhrave të një personi ose subjekti të përcaktuar; ose iii. për të financuar mallra, punime ose shërbime që janë objekt apo ndalohen nga Sanksionet e OKB-së, BERZH-i mund të kërkojë me shkrim që Marrësi të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Grantit dhe shuma përkatëse do të bëhet menjëherë e maturuar dhe e pagueshme sipas kërkesës.

Neni VII Dispozita të ndryshme

Seksioni 7.01. Kohëzgjatja dhe ndërprerja

a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas marrjes nga BERZH-i të një njoftimi me shkrim në lidhje me përfundimin e të gjitha procedurave të kërkuara për hyrjen në fuqi dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë pas nënshkrimit nga Palët. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri sa si Marrësi edhe Subjekti i Projektit të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre në përputhje me dispozitat e saj, përveç nëse ndërpritet më herët sipas parashikimeve të saj.

b) BERZH-i mund, sipas zgjedhjes së tij, ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke dhënë jo më herët se 40 ditë nga njoftimi me shkrim dërguar Marrësit dhe Subjektit të Projektit.

c) Pas ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje sipas paragrafit “b” më sipër, Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të marrin masa të menjëhershme për të reduktuar humbjet dhe për të mbajtur në minimum shpenzimet e mëtejshme në kuadrin e Kontratës së Konsulencës.

Seksioni 7.02. Vlefshmëria e dispozitave të caktuara

Zhdëmtimet dhe garancitë e Marrësit dhe Subjektit të Projektit dhe dispozitat e seksionit 2.03 (*Pagesat*), seksionit 4.06 (*Dokumentacioni dhe Raportet Financiare*), seksionit 4.07 (*Furnizimi me Informacione*), seksionit 4.08 (*Mashtrimi dhe Korrupsioni*), seksionit 4.11 (*Inspektimi dhe Audit*), seksionit 6.03(c), (d) (*Rastet e Rimbursimit*), seksionit 7.02 (*Vlefshmëria e Dispozitave*), seksionit 7.05 (*Gjuha Angleze*), seksionit 7.07 (*Përgjegjësia dhe Zhdëmtimi*), seksionit 7.09 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) do të mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.03. Marrëveshja e plotë, amendimi dhe heqja dorë

a) Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e referuara në të përbëjnë detyrimin e plotë të Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo shprehje paraprake të qëllimit ose kuptimit (gojor ose me shkrim, të shprehur ose të nënkuptuar) në lidhje me këtë transaksion.

b) Çdo amendim i ndonjërit prej termave ose kushteve të kësaj Marrëveshjeje (përfshirë këtë seksion 7.03) do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët. Palët, me marrëveshje, mund ta anulojnë ose ndryshojnë këtë Marrëveshje pa pëlqimin e ndonjë personi që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

c) Çdo heqje dorë nga BERZH-i nga ndonjë prej termave ose kushteve të kësaj Marrëveshjeje ose pëlqimi i dhënë nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga BERZH-i. Në rast se BERZH-i heq një kusht për ndonjë nga Pagesat, duke marrë të ardhurat e kësaj Pagese, Marrësi dhe Subjekti i Projektit do të konsiderohen se kanë pranuar të gjitha termat dhe kushtet e kësaj heqjeje dorë.

Seksioni 7.04. Njoftimet

a) Çdo komunikim administrativ që do të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje për BERZH-in, Marrësin ose Subjektin e Projektit do të jetë me shkrim dhe mund të bëhet me *e-mail* për Palën marrëse.

b) Çdo njoftim joadministrativ, aplikim ose komunikim tjetër që do të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje për BERZH-in, Marrësin ose Subjektin e Projektit do të jetë me shkrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, një njoftim, aplikim ose komunikim i tillë do të konsiderohet i dhënë ose i bërë kur dorëzohet me dorë, postë ajrore ose transmetim elektronik te pala së cilës i kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet në adresën e kësaj pale të specifikuar më poshtë, ose në një adresë tjetër që kjo palë i cakton me njoftim palës që jep ose bën njoftimin, aplikimin apo komunikim tjetër.

Për Marrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

Për Subjektin e Projektit:

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

L. nr. 3 , Rruga Egnatia, Durrës

Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ergys Verdho

E-mail: ergys.verdho@hekurudha.al

Për BERZH-in:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

5 Bank Street

London E14 4BG

United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Mesut Gul, Drejtues i Operacioneve

E-mail: gulm@ebrd.com

Seksioni 7.05. Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe nënshkruar në gjuhën angleze. Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen dhe komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze ose, kur bëhen në një gjuhë tjetër, do të shoqërohen nga një përkthim në anglisht i certifikuar nga Marrësi. Në çdo mosmarrëveshje lidhur me gjuhën, versioni anglisht do të ketë përparësi.

Seksioni 7.06. Të drejtat, mjetet ligjore dhe heqjet dorë

a) Të drejtat dhe mjetet ligjore të BERZH-it në lidhje me çdo dokument të pasaktë ose shkelje të garancisë nga ana e Marrësit ose Subjektit të Projektit nuk do të cenohen nga ndonjë hetim i bërë nga BERZH-i ose në emër të BERZH-it për veprimtarinë e Marrësit ose Subjektit të Projektit, nga nënshkrimi ose realizimi i kësaj Marrëveshjeje, ose nga ndonjë veprim, ose diçka tjetër që mund të bëhet nga BERZH-i ose në emër të BERZH-it në lidhje me këtë Marrëveshje dhe që pavarësisht këtij seksioni 7.06, mund të cenojë këto të drejta ose mjete juridike.

b) Asnjë praktikë veprimi ose heqje dorë nga BERZH-i nga ndonjë kusht i Pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me kushtet e tjera të Pagesave, ose të interpretohet si heqje dorë nga këto kushte.

c) Asnjë veprim i BERZH-it në lidhje me ndonjë nga Pagesat nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik të BERZH-it në lidhje me ndonjë Pagesë tjetër. Pa u kufizuar te sa më sipër, e drejta e BERZH-it për të kërkuar përputhshmëri me ndonjë nga kushtet në këtë Marrëveshje nga i cili BERZH-i heq dorë në lidhje me ndonjë Pagesë është shprehimisht e ruajtur për qëllimet e ndonjë Pagesë të mëvonshme, përveç nëse BERZH-i e njofton ndryshe Marrësin ose Subjektin e Projektit.

d) Asnjë praktikë veprimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin, ose mosushtrimin, e ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik që i llogaritet BERZH-it pas ndodhjes së ndonjë Rasti Rimbursimi apo në kushte të tjera, sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të dëmtojë këto të drejta, kompetenca ose mjete juridike dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë ose pranim në heshtje. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik nuk do të përjashtojë ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e të gjitha të drejtave, kompetencave ose mjeteve të tjera juridike. Asnjë veprim i BERZH-it, në lidhje me ndonjë Rast Rimbursimi nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik të BERZH-it në lidhje me ndonjë Rast tjetër Rimbursimi ose rrethana të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe joekskluzive ndaj ndonjë të drejte ose mjeti tjetër, qoftë të parashikuar nga ligji i zbatueshëm ose jo.

Seksioni 7.07. Përgjegjësia dhe zhdëmtimi

a) BERZH-i nuk paraqet asnjë dokument ose garanci dhe nuk merr asnjë përgjegjësi në lidhje me ndonjë nga Konsulentët ose Shërbimet e Konsulencës. Secila Palë:

i. pranon dhe bie dakord që nuk do të jetë përgjegjëse ndaj palës tjetër për ndonjë përgjegjësi, detyrim, humbje, dëme (qoftë direkte, indirekte, financiare, ekonomike ose të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë shkaktuar ose jo neglizhenca ose mosveprimi i BERZH-it), penaltete, kërkesa, veprime, taksa, detyrime, procese gjyqësore, kosto dhe shpenzime (përfshirë tarifat dhe shpenzimet e këshilltarëve ligjorë ose kostot e hetimit) në lidhje me Konsulentin (përfshirë zgjedhjen, angazhimin ose monitorimin e Konsulentit) ose Shërbimet e Konsulencës (duke përfshirë si pasojë e përdorimit ose mbështetjes në shërbimet e Konsulentit nga Subjekti i Projektit), ose që lindin nga ose në lidhje me një Kontratë Konsulence; dhe

ii. e liron dhe e shkarkon palën tjetër nga çdo kërkesë, e drejtë, borxh, përgjegjësi, kërkesë dhe veprim i çdo lloji ose natyre që tani ose në të ardhmen mund të ketë kundër palës tjetër, të cilat lindin ose kanë lidhje me ndonjë veprim ose mosveprim të ndërmarrë ose të bërë (ose jo të ndërmarrë ose bërë) nga Konsulentët në ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës.

b) Si Marrësi edhe Subjekti i Projektit me anë të kësaj dispozite zhdëmton dhe e bën BERZH-in të padëmshëm përkundrejt çdo veprimi, procesi gjyqësor, pretendimi, kërkesë, humbjeje, tarife, dëmi, kosto dhe shpenzimi, taksa, penaltete dhe përgjegjësi të tjera të shkaktuara BERZH-it/ose të pësuar nga BERZH-i që lindin ose kanë lidhje me Shërbimet e Konsulencës ose sipas ndonjë Kontrate Konsulence.

Seksioni 7.08. Konflikti i interesit

Marrësi dhe Subjekti i Projektit pranojnë se një konflikt i mundshëm ose konkret interesi mund të rezultojë nga dhënia e ndonjë huaje ose investim i kapitalit për Subjektin e Projektit dhe nga roli i BERZH-it në kontraktimin dhe menaxhimin e ndonjë Konsulenti. Marrësi dhe Subjekti i Projektit, sipas këtij neni heqin dorë nga çdo e drejtë që mund të lindë nga një konflikt i tillë i mundshëm ose konkret interesi.

Seksioni 7.09. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Dispozitat e Seksionit 8.04 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të Termave dhe Kushteve Standardë të datës 5 nëntor 2021 do të zbatohen si të ishin të përfshira këtu plotësisht *mutatis mutandis*, me përjashtimin se:

- i. referencat për “Marrëveshjen e Huas” do të lexohen si referenca për “këtë Marrëveshje”; dhe
- ii. referencat për “Huamarrësin” do të lexohen si referenca për “Marrësin”.

Seksioni 7.10. Pasuesit dhe të caktuarit; të drejtat e palëve të treta

a) Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme dhe do t’u shërbejë pasuesve dhe të caktuarve përkatës të Palëve, por Marrësi ose Subjekti i Projektit nuk mund të caktojë ose të transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave ose detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it.

b) Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin “a” më sipër, asnjë nga termat e kësaj Marrëveshjeje nuk synohen për t’u zbatuar nga ndonjë palë e tretë, gjithashtu, edhe dispozitat e Aktit të Kontratave të vitit 1999 (Të Drejtat e Palëve të Treta) janë të përjashtuara dhe nuk zbatohen.

Seksioni 7.11. Zbulimi i dokumenteve dhe të dhënave

a) BERZH-i mund të zbulojë dokumente, informacion dhe të dhëna në lidhje me Marrësin, Subjektin e Projektit dhe këtë transaksion (duke përfshirë kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo marrëveshje tjetër të parashikuar këtu), siç BERZH-i e konsideron të përshtatshme në lidhje me një mosmarrëveshje që përfshin Marrësin, me qëllim të ruajtjes ose imponimit të të drejtave të BERZH-it sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të parashikuar këtu, ose për arkëtimin e detyrimeve ndaj BERZH-it.

b) BERZH-i mund t'i zbulojë Fondit, ose kontribuesve të Fondit, dokumente, informacion dhe të dhëna (duke përfshirë një kopje të kësaj Marrëveshjeje) të furnizuara nga Marrësi ose Subjekti i Projektit, sipas termave të kësaj Marrëveshjeje, siç BERZH-i e çmon të përshtatshme.

c) BERZH-i mund të publikojë përshkrime të Kontratave të Konsulencës, duke përfshirë emrin dhe kombësinë e Konsulentit dhe çmimin e kontratës.

d) Si Marrësi edhe Subjekti i Projektit pranon dhe bie dakord që Banka është e detyruar të informojë Komisionin Evropian nëse, në kuadrin e zbatimit të Grantit, zbulon që:

i. Subjekti i Projektit është një Subjekt i Përgjashtuar;

ii. Subjekti i Projektit ose ndonjë nga përfituesit e Grantit me të cilin Marrësi ose Subjekti i Projektit ka marrëdhënie kontraktuale, është Person i Kufizuar; ose

iii. sa herë vëren një Praktikë e Ndalar dhe/ose parregullsi në pagesën dhe/ose përdorimin e Grantit.

Një informacion i tillë mund të përfshihet në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe të Përgjashtimit, si dhe të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

Seksioni 7.12. Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje dhe secila prej tyre do të konsiderohet si origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj marrëveshjeje, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, siç duhet, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje në datën e përmendur në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: Ervin Mete Nënshkrimi

Titulli: Ministër i Financave

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Nga: _____

Emri: Ergys Verdho Nënshkrimi

Titulli: Administrator

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:

Emri: Ekaterina Solovova Nënshkrimi

Titulli: Drejtor i Asociuar, kryetar për Shqipërinë

SHTOJCA A

FORMA E KËRKESËS PËR PAGESË¹

[në letër me logon e Marrësit]

[data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

5 Bank Street

London E14 4BG

United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Ekipit të Pagesave (APIInvoices@ebrd.com)

Për dijeni: [përfshini emrin dhe adresën e e-mail-it të Drejtuesit të Operacioneve]

¹ Ju lutem dorëzoni një Kërkesë të veçantë për Pagesë për secilën Kontratë Konsulencë të financuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Granti.

Lënda: Marrëveshja e Grantit (Asistencë Teknike) Nr. 17610-132312-132313-53468

Projekti TCRS Nr. 17610

Detyra TCRS Nr. 132312; 132313

DTM Nr. 53468

²**Nr. i Kontratës [numri i referencës],**

³**Nr. i Urdhrit të Blerjes [numri i referencës] Kërkesa për Pagesë Nr. _____⁴**

I/e nderuar Zotëri/Zonjë,

1. Ju lutem referojuni marrëveshjes së grantit të datës [_____] (“Marrëveshja e Grantit”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”), HEKURUDHA SHQIPTARE SHA (“Subjekti i Projektit”) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH”).

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e Grantit do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

3. Kërkojmë pagesën e mëposhtme në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit:

Valuta e Kontratës së Konsulencës: _____

Shuma në valutën e Kontratës së Konsulencës (në shifra dhe fjalë): _____

Valuta e Pagesës (nëse ndryshon nga valuta e Kontratës së Konsulencës): _____

Data e Vlerës: [sa më shpejt të jetë e mundur, në një datë të zgjedhur nga BERZH-i sipas diskrecionit të tij, por jo më vonë se ____]⁵

_____⁶

4. Konfirmojmë se:

a) ju kemi dërguar një kopje të certifikuar të Kontratës së Konsulencës të nënshkruar:

- Kontrata e Konsulencës për [titulli i kontratës] e datës [] dhe të lidhur ndërmjet Subjektit të Projektit dhe [emri i Konsulentit]

⁷[b) Shërbimet e Konsulencës janë kryer në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Grantit dhe Kontratës së Konsulencës;]

⁸c) fatura/faturat bashkëlidhur është/janë të drejta dhe të sakta dhe korrespondojnë me shumat e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës.

⁹[5. Vërtetojmë se kemi paguar një shumë të barabartë me çdo taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) në të gjitha faturat e mëparshme të Konsulentit dhe marrim përsipër të paguajmë Taksën indirekte (duke përfshirë TVSH-në) në faturën[at] për të cilat bëhet kjo Kërkesë për Pagesë brenda [30 ditëve] nga data e kësaj Kërkesë për Pagesë.]

6. Për qëllimet e Seksionit 3.02 (*Të gjitha Pagesat e Grantit*) të Marrëveshjes së Grantit, paraqesim dokumentet dhe garantojmë që:¹⁰

a) përfaqësimet dhe garancitë e paraqitura ose të konfirmuara nga Marrësi dhe Subjekti i Projektit në këtë Marrëveshje janë të vërteta dhe të sakta në datën e sotme;

² Shtoni numrin e referencës së Kontratës për të cilën kryhet Kërkesa për Pagesë.

³ Numri i Porosisë së Blerjes duhet të kërket nga Drejtuesi i Operacioneve pranë BERZH-it përpara lëshimit të Kërkesës së parë për Pagesë që duhet të përfshihet në çdo Kërkesë për Pagesë.

⁴ Çdo Kërkesë për Pagesë duhet të numërohet në seri.

⁵ Nëse Pagesa kërket në datën e një vlere specifike, fshijini fjalët në kllapa.

⁶ Kjo datë nuk duhet të jetë më herët se 10 Ditë Pune pas dorëzimit të Kërkesës për Pagesë te BERZH-i.

⁷ Fshijeni për pagesën paraprake ose modifikojeni në raste të tjera sipas nevojës, p.sh. nëse Përfutuesi pranon vetëm një pjesë të shërbimeve dhe, si rrjedhojë, kërkon pagesën e vetëm një pjese të faturës.

⁸ Si më sipër, modifikojeni sipas rastit.

⁹ Përfshijeni nëse ndonjë taksë indirekte (përfshirë TVSH) është e ngarkueshme në lidhje me Kontratën e Konsulencës (shih seksionin 2.04 (c) (*Taksat dhe Detyrimet*)).

¹⁰ Pikat e mëposhtme duhet të pasojnë paragrafët përkatës në seksionin 3.02.

- b) asnjë Rast Rimbursimi nuk ka ndodhur dhe nuk është në vijim;
 c) asgjë nuk ka ndodhur që mund të ketë efekt material negativ mbi Marrësin, Subjektin e Projektit ose Projektin; dhe
 d) Kontrata e Konsulencës është në fuqi dhe efekt të plotë dhe asnjë ndryshim material nuk është bërë në të.

7. Bashkëlidhur kësaj Kërkesë për Pagesë paraqitet:

a) një kopje e faturës/ave së Konsulentit në lidhje me të cilat kërkohet Pagesa [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse];

b) dokumentet e tjera që BERZH-i ka kërkuar [, duke përfshirë: i. prova për përdorimin e propozuar të të ardhurave të Pagesës; dhe ii. prova për përdorimin e të ardhurave të Pagesës/ave të mëparshme], si dhe çdo dokument ose informacion tjetër që jemi të detyruar t'i ofrojmë BERZH-it sipas Kontratës së Konsulencës.

8. Duke lëshuar këtë Kërkesë për Pagesë, Marrësi dhe Subjekti i Projektit autorizojnë BERZH-in që t'i kryejë Pagesën Konsulentit sipas Kontratës së Konsulencës.

Me respekt,

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar¹¹

SHTOJCA B
 FORMA E CERTIFIKATËS SË DETYRËS DHE AUTORITETIT
 [Letër me kokë e Subjektit të Projektit]

[data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
 5 Bank Street
 London E14 4BG
 United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)
 Në vëmendje të: []

Lënda: Marrëveshja e Grantit (Asistencë Teknike) nr. 17610-132312-132313-53468

Certifikata e Detyrës dhe Autoritetit

I/e nderuar Zotëri/Zonjë,

Referuar Marrëveshjes së Grantit të datës [data] ("Marrëveshja e Grantit") ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Marrësi"), HEKURUDHA SHQIPTARE SHA ("Subjekti i Projektit") dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka"), ju informojmë se personat, nënshkrimet autentike të të cilëve jepen më poshtë, janë të autorizuar në emër të Subjektit të Projektit [i.] si Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit për qëllimet e seksionit 2.02(a) të Marrëveshjes së Grantit për të nënshkruar Kërkesat për Pagesë dhe dokumentet dhe provat shoqëruese; [dhe ii. lidhur me [çdo njoftim ose dokument] që duhet të nënshkruhet në emër të Subjektit të Projektit] të kërkuar ose të lejuar për t'u nënshkruar sipas Marrëveshjes së Grantit të përmendur më sipër.

EMRI	POZICIONI	MODELI I NËNSHKRIMIT
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

¹¹ Personi që nënshkruan Kërkesën për Pagesë duhet të ketë emrin në Certifikatën e Detyrës dhe Autoritetit.

Të gjitha njoftimet e mëparshme që ofrojnë nënshkrime të zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar në emër të Subjektit të Projektit, sipas Marrëveshjes së Grantit të lartpërmendur, revokohen.

Me respekt,

Për dhe në emër të:

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Nga: _____

Emri:

Titulli:

SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E LETRËS QË ÇAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

- Letra e mësipërme e autorizimit duhet të nënshkruhet në emër të Subjektit të Projektit nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Subjektit të Projektit.

- Në rast se çdo dokument duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, letra e autorizimit duhet ta shprehë qartë këtë dhe fjalia e parë duhet të rregullohet sipas rastit.

Nëse nënshkruesit e autorizuar janë të ndarë në dy grupe, dhe kërkohet nënshkrimi i një zyrtari nga secili grup, kjo, gjithashtu, duhet të specifikohet qartë.

SKEDULI 1 ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI

Zërat e Financuar nga Granti, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përfshijnë shërbimet e mëposhtme të konsulencës:

Zëri	Emri i detyrës	Numri i detyrës	Shuma, deri në
1.	Mbështetje për Zbatimin e Projektit	132313	7,500,000 ¹² euro
2.	Mbikëqyrje e Punimeve	132312	

¹² Raporti i pritshëm midis Mbështetjes për Zbatimin e Projektit dhe Mbikëqyrjes së Punimeve është përkatësisht EUR 1,000,000 dhe EUR 6,500,000, sipas Formularit të Aplikimit për Grantin (WB-IG06-ALB-TRA-02).